ADEM ZAPLLUZHA

SHI NË QYTETIN TIM

Redaktor:
Dibran Fylli

Recensent:
Dibran Fylli

Lektor:
Veli Veliu

ADEM ZAPLLUZHA

SHI NË QYTETIN TIM

Shoqata e Shkrimtarëve
"Fahri Fazliu"
Kastriot, 2014

SOT KOHA NDRYSHON, SHIUN E SJELL VARGU POETIK

Shi bije edhe në qytetet tjera të vendit tim, por shiu në qytetin tim ka një kuptim të veçantë! Pas tij mund të shihej ylberi, fëmijët e ylbertë, njerëz fytyrëqeshur e shpirtmirë. Pastaj paraqitet piktori me brushën e tij duke i dhënë shpirt edhe gurit edhe drurit, edhe jetës …

Nuk di se çfarë kuptimi kanë gjërat që nuk ekzistojnë
Piktori i japë shpirt gurit…

Duke e lexuar veprën poetike të poetit Adem Zaplluzha, "Shi në qytetin tim", është e pamundur që të mos mendosh për shumëçka që nuk ke menduar kurrë më parë, vërtetë është një libër jetësor me aq shprehje poetike, të cilat rrallë i hasim nëpër vepra poetike, sidomos në këtë shekull kur poezia moderne ka përfshi mendjet e shumë poetëve.

Në fund të tregimit,
i harrojmë parathëniet e ngjyrave…

Duke e analizuar librin poetik të Adem Zaplluzhës "Shi në qytetin tim", hasim në shprehjet bindëse të krijimtarisë artistike të cilat pa mëdyshje tërheqin vëmendjen e studiuesve të letërsisë dhe të kritikëve. Të vargu i poezisë së Zaplluzhës fshihet magjia e shpirtit të njeriut. Ai hap pas hapi kërkon bardhësi, jetë, shpirt...

Nga bardhësia e zambakëve,
mundohemi ta shtrydhim bardhësinë…

Libri përmbledh një varg poezish të shkruara me gjuhën e zemrës, me dashuri por dhe me një shqetësim që ideon nga shpirti i autorit, jo vetëm kur ai ulet në tavolinën e punës, për të bërë vargun e tij thuajse magjik, por edhe kur udhëton nëpër qytet i shoqëruar me idetë e tij prej krijuesi të mbi 105 veprave poetike e letrare...

Kur jemi të nevrikosur,
ecim nëpër vetminë e rrugëve…

Poeti Adem Zaplluzha paraqitet ashpërsisht në poezitë e tij, sidomos kur gdhend vargjet duke paraqitur një mjegull që edhe sheh çdo gjë edhe nuk sheh asgjë nga asgjëja.
Por së fundmi është Zaplluzha ai që revoltohet në ndërtimin e vargut poetik, duke sjellë para lexuesit revoltën e tij, të adresuar në vendin e duhur, në mes vargjeve, rreshtash e tregimesh në jo më pak se të 104 botimeve të këtij poeti.

Mjegullat sillen vërdallë
Si vagabondët pa adresë…

Dibran Fylli, regjisor

Kah po ikin ditët
Cikli i parë

ASNJË MUR NUK HAPET

Mbase mbi njëqind vjet
Po trokas në dyert e kujtesës
Asnjë mur nuk hapet
Në horizontin e përmbytur
Si drurët po vdes
Një merimangë e zezë

Malit iu është ngushtuar frymëmarrja
Po ecën si ariu i plagosur
Njerëzit me nga një kërrabë
I shkulin kujtimet e lisave
kurse gjelbërimi dënes
Si një mjellmë e plagosur

Një krijesë e moshuar
Si një hije e verbët
Kalamendet shëtitoreve të zbrazëta
Bredhin edhe vitrinat e kukullave
Si asnjëherë më parë
Trishtimi
Në një kor antikë
Reciton poemën e mjerimit

2.

Nëpër rrugë
Tok me endacakët e verbër
Shëtisin
Edhe këmishët e shqyera të mjegullave

Një kohë pakëz më ndryshe
Se ajo e djeshmja
Si një këndes i egër
Rri në degët e Shpirtit bredhës

Mjaullima e maces
Bisedon me një qukapik
Nata çukit
Mbi trupin e lodhur të rrapit

Era e dërmuar nga shtegtimet
Mbi një dunë dhembjeje
I ka shtrirë duart e lodhura
I ka shtrirë në drejtim
Të përmbytjes së lumenjve

3.

Kjo ditë e çrregullt po ikën
Nëpër ullukët e çatisë
As era e shfrenuar
Nuk ndalet në asnjë shteg
Një dorë e zbehtë
Po i përngjan një cope të vjetër ashti

Rrapi i vjetër
Mbanë mbi shpatulla
Çelësin e një porte kaherë të mbyllur
Nga gryka e Lumëbardhit
Hijerëndë po zbret
Ofshama
Po zbresin njerëzit
Me shpresa të thyera
Po zbresin hijet

4.

Në honin e mendjes
Mbeta pa asnjë fjalë
Mu duk se këmbët zhyteshin
Në një masë të zjarrtë

Shikoja lartë
Yjet iknin tej përtejmes
Kurse poshtë këmbëve
Prekja diçka të papërcaktuar

Ishte hera e parë
Që ky lloj trishtimi
Nuk kishte peshë në qenien time

Binte një shi i mëndafshtë
Mbi krahët e fluturës
Nëpër degët e akacies
Dënesnin cicërimat e zogjve

Eca deri te shelgu lotues
Dhe pash se si lëpihej druri
Lëpihej era
Si ariu i plagosur

5.

Ky peizazh trishtimi
Po ecën deri në pafundësi
Po ecën si njerëzit dhe drurët
Asnjë stinë nuk kalon këndej pari
Pa e lexuar parathënien e erës

Na ka lodhur thatësia
Shirat më nuk po vijnë këndej
Era qan te plepat
Nuk ndalet vaji i shelgjeve të pikëlluara

Çdo gjë sonte po i përngjan vetmisë
Qan era si kukullat nëpër vitrinë
Kurse këto mure s'i prek dora e njeriut
As nuk shemben nga era

PIKTORI I JEPË SHPIRT GURIT

Nuk di se çfarë kuptimi kanë
Gjërat që nuk ekzistojnë
Piktori i japë shpirt gurit
Që të mburret shtatorja
Me duart delikate të trëndafilave

Nga bardhësia e zambakëve
Mundohemi ta shtrydhim bardhësinë
E një eliksiri të mëndafshtë
E cila bardhësi
Asnjëherë nuk pranon dështimin
E lindjes së gjelbërimit

Kur jemi të nevrikosur
Ecim nëpër vetminë e rrugëve
Si somnambulët
Dhe kur mbërrimë pa dashje
Në fund të tregimit
I harrojmë parathëniet e ngjyrave

KAH PO IKIN DITËT

Ky dimër
Po ikën me bastun
kah majat e egra
Ku t'i lë duart e ngrira
Kallkanët më shikojnë me ironi
A ka emër kjo jetë që po ikën

Kur ishim bashkë
Dëgjonim se si qante era
Kurse sot
Po dënesi në vetmi
Si quhet lumi që po shteron

Më janë ngrirë lotët
Një grusht borë s'paska mbetur
Në kepin e shpresës së kujtimit
Kah po ikin ditët
Në cilin det po ndodh
Përmbytja e zogjve të bardhë

MBRËMË QANTE ERA

Mendova se lumi e ndërron rrjedhën
por jo
Derdhet si përherë
Në shtratin e vdekur të kohës

Një erë e marrë po troket në kujtesë
Erdhën edhe ujkonjat
Netët po ulërijnë
Ashti siç ulërinin në kohërat e liga

Kah t'i drejtojë lutjet
Mëkati i kujt më zuri në këtë shteg
Mbrëmë i dëgjova lutjet e fundit
Dëgjova
Se si qante era e përlotur

NATA ISHTE E GJATË

Thonë se ankthi është
Një pjesë e pandashme e gjumit
Kurse unë mendoj
Të kundërtën
Gjumi është ajo pjesë e ankthit
Kur i dëgjon britmat Frojdjane

Një eunuk për çdo ditë
I mjelë yjet
Kur në netët e vona
Gjumi hynë nëpër ledhnajat
E ëndrrave
Për t'i zënë ngushtë zhgjëndrrat

Mbrëmë vërejta se si dënesnin
Me mallëngjim vajtonin
Boçat e orës
Nata ishte e gjatë
Kurse tiktaku i akrepave
Ende këndon një elegji
Të pa kënduar deri më sot

KAM FRIKË

Kam frikë
Këto pamje groteske
Po më duken si leckat e një beteje
Diku në majat e majave
Një korb i zi
Nuk i ndalë krakëllimat

Mjegullat sillen vërdallë
Si vagabondët pa adresë
Shëtisin hijet
Një natë e zorshme si kjo
Më duket se asnjëherë s'ka ngjarë
Në mendjen time

Kjo frikë ka diçka të tmerrshme
Në brendinë e saj
I zgjatë duart thellësive
Dhe në fund të udhës
Mbytet në gjolin e një dallge pa emër
Kam frikë
Paskam shumë frikë
Nga kjo lojë përplot lemeri

NJË PIKË LOTI KËTU

Në këtë azil
Nuk vjen askush
Më kuptoni këtu s'ka njerëz
Po sa hynë nëpër këto porta
Shndërrohen në hije të murrme

Një pikë loti këtu
I mbytë të gjitha detet
Oqeanet janë aq të vegjël
Sa që humbin
Në sytë e përlotura të gjelbërimit
Si vesa e agullimës

Ju thash se këtu s'ka më lot
Janë tharë detet e syve
Në këtë azil të paemër
Vetëm pas qepallave të thinjura fshehin
Njerëzit më grotesk të kohës

NUK ËSHTË MË AJO GRUA

Nën këtë çati dëgjohen
Vetëm mjaullimat e maceve
Në disa raste
Fluturojnë korbat
Me nga një zarf prej bloze

Si njerëzit qajnë netët
Dyert e vjetra të dhomave
Kërcasin
Tok me eshtrat e mureve
Çdo gjë në këtë mjedis lëngon

Në një vazo të zbrazët
Nga pakujdesia
Kanë zënë e po vdesin lulet
Po vdesin edhe saksitë në dritare

Nuk është më ajo grua
Që kujdesej
Për milingonat
E dërrasave të kalbura
Pa u përshëndet me askënd
Ajo iku tejpërtejmes

JANË LODHUR EDHE DEGËT

Kur kthehem në shtëpi
Kaloj pranë rrugës së azilit të pleqve
Kthehem me taksi
Ose kalëroj
Mbi ndonjë kali të çmendur

Shoh të lodhur blirin e lagjes
Dikur në adoleshencën tonë
Na bënte hije
Kur këndonim serenatat Korçare
E sot na shikon me sy të mekur

Janë lodhur edhe degët
Gjethet e thinjura prej viteve
Na shikojnë me qepalla gjysmë të mbyllura
Stoli më as që ekziston aty

Nën blirin tonë ku i përjetonim
Dashuriçkat e rinisë
Sot rrinë nën të njerëzit
Pa shpresë
Se do lindi një ditë e re

Prishtinë, 25 janar 2014

KUR QAN DRURI

Si milingonat e verdha
Ecim trotuareve
Herë i përngjajmë xunkthit
E herë
Nuk i përngjajmë as vetvetes
Në shumicën e rasteve
Imitojmë kukullat nëpër vitrina

Kalojmë prej një ane të shthurur
Në anët tjetër të mendimeve
Nuk zëmë vend
Në asnjë lima
Nëse kthehemi në atdhe
Udhëtimin e bëjmë me anije të vdekura

Nuk na njohin shelgjet e lotuar
Kur qan druri
Nga degët s'pikon loti i gjetheve
Por një lloj rrëshire
Nga e cila shërohen mushkonjat e zeza

Nganjëherë ecjet i kemi të ngathëta
Nën pemët e vrara të lagjes
Sivjet vetëm çafkat e trishtuara pushojnë
E ne ecim si kuajt
Vetëm në një drejtim ecim
Sepse këtë gjuhë të ecjes
E mësuam nga milingonat

NJERËZIT E QYTETIT TIM

Shoh rrugëve njerëz të vegjël
Por me shpirtra të mëdha
Herë ecin horizontalisht
E herë vertikalisht
Por ecin
Nuk ndalen
As kur u mungon frymëmarrja

Këta njerëz të mëdhenj
Si peri përbirohen
Nëpër veshin e gjilpërës
Dhe kur mbërrin në shpirtin e vuajtjes
Si terezitë në zë i qepin ditët
Në lëkurën e regjur të erës

Nuk dinë të ankohen kur bie shi
As bora nuk i frikon
Një shpresë e bardhë
E mbron zemrën e tyre të ngrohtë

Si nëpër një ëndërr të mirë
Parakalojnë nëpër shtegun e dhembjes
Me padurim presin të zgjohen të nesërmen
Si këndesi shkunden shpatullat
Dhe me shikime të dëlira
E shikojnë të ardhmen drejtë në sy

Njerëzit e qytetit tim
Kanë një cak dhe një qëllim
Në ecjet e tyre vertikale
Në pëllëmba e shohin të nesërmen
Udhëtojnë me avion prej shakulline
Dhe kur mbërrin në stacionin e pritjes
Pashmangshëm takohen me ëndrrat e tyre

SA HERË QË U TEKET

T’ju them të drejtën
Njerëzit në këtë qytet vdesin si zogjtë
Të hënën takohesh me mikun
Në kafenenë e njohur te plepat
Dhe të martën për herë të fundit
Përshëndetesh me të te varret

Njëri ikën sot
Kurse tjetri pa vonesë
Me një shall rreth qafe
Rrinë varur
Për degën e duditë të vjetër
Duke e soditur horizontin
Se si zvogëlohen pamjet diku në largësi

Miqtë tanë largohen
Ikin në një mënyrë më misterioze
I lënë këpucët pranë xhamisë
Dhe nuk kthehen
Për t’i mbathur më asnjëherë

Nga aty largohen ato këpucë
Vetëm atëherë
Kur vijnë arixhinjtë për avdesin e drekës
Kështu e kanë miqtë e mi
Sa herë që u teket
Bëhen një pjesë e humbur
Në brendinë e një qivuri prej bredhi

THUA SE VAJTONTE EDHE HYJI

Më 13 Mars 1913 fshati malor Kabash përjetoi natën më të tmerrshme në historinë ekzistuese të tij. Pse ndodhi ky krim i rëndë njerëzor, një ngjarje e llahtarshme e përjetuar nga populli shqiptar në historinë e tij? Pse serbët e bënë këtë kasaphane në Kabash? Çka i shtyri kasapët serbë që në Kishë të fshatit Kabash ta bëjnë masakrën?!

Avdi Ibrahimi

Vonë kuptova
Më duket se ishte tepër vonë
Kur kuptova zbritjen e zogjve të verbër
Mbi çatitë e rrënuara të Kabashit

Krakëllinte nata e zezë
Sterra si katran
Lyhej për shpirtin e trishtimit
Ofshante Drini
Gjëma e lumëbardhit dëgjohej përtej Alpeve

Këlthitnin drurët me zë njeriu
Si një qilimi dëneste
Ashte e Keqe
Kabashi i Prizrenit rrinte mbështjellë
Me një zymtësi prej gjaku

Nëntëdhjetë plepa veshur në xhubleta
Pritnin të heshtur dhe të mërrolur
Radhën e ofshamës
Ofshante edhe guri i murrmë
Tok me Ashtën e Keqe ofshanin malet

Në Kabash rra në provim njerëzimi
Zgërdheshej si një soj kudre
Spirë Kapiteni
Dhëmbët e përgjakura të Fil Dellovcit
Pikonin një lloj rrëshire të zezë

Binin teposhtë honit shpirtrat e lëmekur
Festonte lukunia e çetnikëve
Atë ditë binte një shi i zi
Thua se vajtonte edhe Hyji
Pafajësinë njerëzore

I SHEMB TË GJITHA MURET

Sa shumë na ka ndryshuar
Kjo kohë
Ecim me vetveten
Nocioni i bashkëjetesës
Është një mollë e ndaluar
Sa herë që e kafshuam na i theu dhëmballët

Fqinji me fqinjin
Gjuhen me shikime të tharta
Mes njerëzve
Ka hyrë një djall i zi
Sa herë që e dredh bishtin
Fryhet lumi i çmendur i mendjes

Nëpër lagje kalojmë si të huaj
Kali nuk e njeh të zot
Sa herë që i mungon trasta me tagji
Me shqelma
I shemb të gjitha muret

Ky nocion ka vetëm një emër
Të dashuruarit e quajnë xhelozi
Çfarë emri do t'i japin
Ata njerëz
Që kurrë nuk ditën me dashtë

NJË SY I HAPUR SI DETI

Pas një nate papandehur
Ngjau vajtje ardhja
Nuk di a ishte fillimi
Apo fundi i gjenezës

Një kryq pakëz më ndryshe
Si ky i sotëm
Qante mbi një dunë prej mjegulle
Me lot prej shiu
Qanin edhe egërsirat e maleve

Ti ishe diku larg meje
Ishe në mesin e tregimeve
Baladat posa kishin zënë të flasin
Gjuhën e tyre prej guri

Nata kishte etje të madhe
Thyheshin eshtrat e të vdekurve
Në rrugën e Golgotës
Qante një njeri i huaj
Qante edhe qielli i dëshpëruar

Një sy i hapur si deti
Shikonte nocionin e masës
Si delet e egra kalonin njerëzit
Ecte edhe një bastun pas tyre

Një bari me sandale të kuqe
Shkelte mbi detin
E trishtimit të ditës
Një ecje
E cila akoma vazhdon rrugëtimin e nisur

E RASTISI LUSTRAXHIUN BAJRAM

Kur kthehem në qytetin tim
Te Ura e Gurit
E rastisi lustraxhiun Bajram
Njeriun me një kapelë të vjetër
Që i di të gjitha ngjarjet e qytetit

Ky burrë zeshkan
Bisedon me të gjitha llojet e sandaleve
Numrat e këpucëve të secilit prej nesh
E di përmendësh

Më shumë se biblën i do ngjyrat
Duart e tij të vogla
Ia kalojnë
Çdo marinari në mjeshtërinë
E përdorimit të lidhëseve
Të këpucëve

Kur e zë malli për lustrimin
E këpucëve
Mu si salepxhiu i thërret myshterinjtë
Me kokën e vogël nën kapelë
Lustron deri sa i sheh këmbët
E nuses së vet cigane

Prishtinë, 26 janar 2014

Nëpër stacionet e pritjeve
Cikli i dytë

KURSE NE VENDNUMËROJMË

Kjo rrugë nuk ishte në lagjen tonë
Më kujtohen kalldrëmet
Dhe njerëzit me pamje groteske
Kuajt duke çaluar bartin dru
Të shkulur
Nga ashpërsitë e maleve

Edhe njerëzit
Disi ecnin si të hutuar
Takoj hamaj ngarkuar me mallra
Për të kamurit
Dhe fëmijë të braktisur
Që bredhin udhëve dhe faltoreve

Kjo rrugë nuk ishte në lagjen tonë
As ne nuk ishim kështu
Siç jemi sot
Shoh njerëz me pantallona të shkurtra
Dhe pallto të gjatë dimri
Me ca kapela e mjekër të thinjur

Rruga ime eh një nostalgji
E cila kurrë më nuk kthehet
Po ikën ledheve të pa kthim
Kurse ne vendnumërojmë
Dhe habitemi me ndryshimet atmosferike

SYTË I KEMI TË URITUR

Në këtë qytet ka njerëz
Që përpos buzëqeshjes asgjë tjetër s'kanë
Kur dalin të shëtisin ecin si devetë
E shkretëtirës
Në kalim e sipër
I numërojnë hapat e huaja

Askush askujt nuk i përngjan
Aq shumë ndryshojmë nga njëri - tjetri
Sa që dallojmë si nata me ditën
Por në thelb s'dallojmë aspak
Secilin prej nesh
Na mundon i njëjti problem

sytë i kemi të uritur
Asgjë s'mund ta ngop
Pangopësinë e përditshmërisë
Njerëzore
Në këtë sëmundje
Takohemi me çdo kë
Akoma nuk u gjind eliksiri
Për shërimin e këtij vesi të stërkequr

PO THAHEN PEMËT E PJEKURA

Është vjeshtë e vonë
Stina e të reshurave
Kurse nuk bie shi as në gjumin
E llamarinave të çatisë

Po thahen pemët e pjekura
Stina anemike ecën e lëmekur
Degët e ngarkuara përkulen deri në tokë
Bisedojnë me frytet e kalbura

Shi nuk bie as mbi çatinë tonë
Më janë shterur kordhat zanore
Një këngë të vjetër fërshëllen komshiu im
Fërshëllen
Edhe era serenatën e një kohe

Është vjeshtë
Dimri veç ka zënë
E po na i ngrinë mendjet tona
Frytet po kalben nëpër fusha
Një qukapik
Troket në dyert e rrapit të moçëm

DY TË DASHURUAR

Për çdo ditë i shoh në shëtitore
Një burrë dhe një grua të moshuar
Çapitin ngadalë
Çapitin nëpër shpirtin e sheshit

Ecin si në kohën e adoleshencës
Dorë për dore
Përplot hare dhe gëzim
Cicërojnë si zogjtë në degët e qershisë

Ai me pantallona të zeza
Kurse ajo me një bluzë të kuqe
Kjo ishte uniforma e tyre
Kur ishin mësues

Çdo i dyti kalimtarë ëmbël i përshëndet
Këta edhe më ëmbël
Ua kthejnë
Përshëndetjen duke qeshur

Ecin shëtitores
Si në kohën e adoleshencës
Shikojnë në sy njëri - tjetrin
Që s’kanë kohë të mendojnë
Për Shën Valentinin

DUA QË NË KËTË VETMI

Kjo lojë shahu vetëm mua më përket
Dua të luaj sonte
Me vetveten
Le ta merr kush do mbretëreshën
Mua më mjaftojnë kalatë

Dua që në këtë vetmi
T'i shaloj mendimet
Të bëhem
Një pjesë e imagjinatës
S'kam nevojë
Për asnjë ushtar të hekurt
Lufta ime
Ka kohë që ka përfunduar

Vetëm ky shi imcak
Po tringëllon
Si një zile e kujtesës
Dëgjohet në kokën time
Pa reshtur po bie
Mbi barin e njomë
Po i zgjon nga gjumi ëndrrat e mia

Shiu unë dhe imagjinata
Sonte bisedojmë
Në një trio të paparë
Vetëm flladi i natës
Me dorën e tij
Si engjëlli
Më kthen në fëmijërinë time

NË DISA RASTE EKSTREME

Njerëzit në këtë qytet
Ecin si drurët
U përngjajnë kuajve të verbër
Kur kanë probleme fiziologjike
Merren me të tjerët

Në disa raste ekstreme
Nuk e njohin as vetveten
Shikojnë një pikë të papërcaktuar
Dhe nuk i luten hyjit
Në gjuhë time

Thonë se nuk e përkrahin mëkatin
Kinse jetojnë
Me duar të pastra
Kurse në anën tjetër
Më shumë krijojnë armiq se sa miq

Çuditërisht
Ecja e tyre është pa frymëmarrje
Bredhin si turtujt nëpër ferra
Sa herë që fluturojnë lartësive
Po me atë shpejtësi
Fundosen nën këmbët e veta

PA PASAPORTË BIOMETRIKE

Dashuroj në mënyrën time
Gjërat i shoh
Po ashtu vetëm se si dëshiroj
T'i shoh
Ky jam unë i tëri
Brenda nocioneve ekzistuese

Kur kam etje
Papandehur ndalem
Mbi një cep të ekzistencës
Dhe i shtrydhi mjegullat
I shtrydhi
Derisa shndërrohem në det

Më pastaj i kalëroj
Kuajt e mi të erës
Dhe mbi krahët
E një korbi të bardhë
I arnoj flatrat e grisura të qiellit

Më vonë
I bashkohem imagjinatës
Dhe pa pasaportë biometrike
I kapërcej
Kufijtë e të pamundshmes

MOS ËSHTË ÇMENDUR BUNACA

Nuk jam duke kuptuar
Por për çdo ditë
Mbi kokën time të thinjur
Shoh qiellin e dëshpëruar
Dhe fluturat e bardha
Duke ikur deri te mështekna

Një hije e grisur pikon
Si rrëshira pikon
Mbi çarçafin e bardhë të stinës
Andej maleve
Me tërbim frynë deniku
Do jetë i acartë moti sivjet

Nga majat e bjeshkëve
Zbresin gjethet
Zbresin ngjashëm pikëllimeve
Pak shi do të ketë sot
Për etjen e rrënjëve të rrapit

Po frynë një tjetër frymë
Mos është çmendur bunaca
Nuk dihet
Se kush i shkyçi dritat e fanarit
Sonte varkat paskanë mbetur
Në mëshirën e dallgëve

KUR PRISHET MOTI

Kur hidhërohet
Qyteti im i fëmijërisë
Frymon si gjethet
Ndonjëherë i përngjanë turtullit
Ndonjëherë endacakëve pa shtëpi

Kur prishet moti
Fryhen përrenjtë
Çatitë rëndohen nga çafkat
Në kohëra të liga
Shumë pak vend ka për pëllumba

Lumëbardhi fare mirë e njeh
Rrjedhën e ujit
Kur janë në qejf zogjtë e ujit
Në agullimën e parë
Bisedojnë me algat e murrme

I do njerëzit kur dashurohen
Për çdo mbrëmje këndon serenata
Nga uji
Kurse për grindavecët
Sa ora i zgjohen teket
Prej dallgëve të çmendura

MË PRESIN TË PARËT E MI

Mbi shpirtin tim të lodhur
Nuk këndon më asnjë lloj zogu
Kam mbetur i vetmuar
Si një turtull i verbër
Në këtë breg shkëmbor

Më janë thyer krahët
Sytë e lëbyrtë
S'dallojnë natën nga dita
Kjo frymëmarrje e turbullt
Mbytet në mua
Si anijet endacake nëpër liqe

Ecja ime e ngathët po i përngjan hijes
Në çdo hap
Thyhet si gota e kristaltë
Nëpër akullin prej kallkanëve
Po shkas për çdo ditë nga pak

E di udhën time
Një ditë do të kthehem në atdhe
Më presin të parët e mi
Të cilëve
U kam mbetur borxh nga një epitaf

ATDHEU ËSHTË SHUMË LARG

Në fund të rrugës
Më presin zogjtë me sqepa të verdhë
Përtej asaj errësire
Më presin
Te fundi i një drite edhe pulëbardhat

Ky det i çmendur i fëmijërisë
Me qindra vjet
Nuk i ndali llamburitjet
Në bregun e majtë të kujtesës
Më pret brendia e një guaske

Një ditë do të nisem
Këtu më nuk më ka mbetur
Asnjë fije shprese

Por ku të shkoj
Kah të ja mbajë në këtë natë të vonë
Atdheu është shumë larg
Kurse ti më shikon si shpendi i zi

NËPËR STACIONET E PRITJEVE

Jashtë dhomës sime
Nuk rehatohet gjumi i natës
S'flenë as zërat e trishtuara të zogjve
Era kundërmon
Si hudhrat e fishkura nëpër dyer

Në kopshtin e fqinjëve
Kanë zënë
E po këputen boçat e pishave

Një laraskë vuan nga vetmia
Mjegullave të mbrëmjes
U ka ikur gjumi
Mbase askush sonte nuk fle

Mbi çatitë e kalbura nga stinët
Rigon një shi i bezdisshëm
Asnjë meteor i këputur
S'bisedon me hënën

Një qetësi e zymtë
Pikon mbi një hambar
Mbuluar me kashtë prej thekre

Dikur vonë
Më duket se kishte kaluar
Një pjesë e madhe e natës
Dëgjova disa zëra të përziera
E të mekura zogjsh
Duke i lutur kometat
Të mos mbesin pa shpresë
Nëpër stacionet e pritjeve
Si zogjtë e trullosur të natës

Prishtinë, 27 janar 2014

DIMRI KURRË NUK ZË VEND

Ajo ecë duke shkelur lehtazi
Mbi mendimet e një ëndrre
Pas shpinës nga nëntoka
Burojnë pasionet e etjes
Ecën ajo
Si zëri i shiut mbi çatitë e qytetit

Ka një pamje misterioze
Nga sytë e saja blu
Në të katër anët e rrugës
Derdhen shikimet ngjyrë jargavani
Parakalon trotuareve
Me një fustan të tejdukshëm

Vetëm ecja e saj gracioze
Ka një madhështi ujore
Kur qesh
Shkunden lulet e vishnjave
Në shenjë respekti drurët në bulevard
Përkulën deri në tokë

Ajo buzëqesh si pranvera
E ka dukjen e vjeshtës së begatë
Dimri kurrë nuk zë vend
Në shpirtin e saj
Përherë i përngjan dallgëve të Adriatikut

PO QË SE ZEMËRIMI

Zemërimi është një nocion
I huaj për mua
Gjërat i shikoj ashtu siç duken
Në shikim të parë
Fare nuk bezdisem
Se si dukej dje hija e asaj peme

Në çdo degë të thatë
Shoh duke bulëzuar lulja më e bukur
Kur është vera pa shi
Mbi gjelbërimin e shpirtit
I shtrydhi lotët e mjegullave

Gjithmonë stinët dhe ditët
Janë të bukura
Kur bie
Dhe kur nuk bie shi
Bari mbinë edhe në shpirtin e gurit
Po që se zemërimi
Nuk duket fare në horizont

FILLON STINA E KALLKANËVE

Nën degët e pemëve të lodhura
Flenë zogjtë shtegtar
Njerëzit dhe milingonat
Nuk i lënë gjethet të kalben në tokë

Dikur vonë kur largohen
Zogjtë me vjeshtën
Fillon stina e kallkanëve
Në gjumin e përfëllizës
Acaret zënë një vend nderi

Nëpër ajrin e kristaltë vijat e tymit
Formojnë disa lloje arabeskash
Kolliten oxhakët
Si drurët
Kolliten edhe turtujt

Nën çatitë e lëna peng
Nuk dimërojnë shpendët
As pemët
Vetëm patat e egra pushojnë këtu
Ose i lënë vezët
Për vazhdimësinë e llojit

SI DUART E XEHETARËVE

Miku im po që se ndalesh
Të mendosh
Do i shohësh gjërat pak më ndryshe
Sepse edhe ato ndryshojnë
Kur orë e çast
I ndërrojnë kahet e fluturimeve

Një ditë janë të kthjellëta
Kristalore
Kurse ditën tjetër të duken të vrazhdë
Me kallo
Si duart e xehetarëve

Herë janë të ngarkuara si trenat
E herë hingëllojnë si kuajt
Në asnjë kohë dhe çast
Nuk i përngjajnë njeriut
Ani që jetojnë në shpirtin e tij

Mendime zogjsh në fluturim
Dhe të avionëve prej letre
Janë njëlloj si ato që flenë
Në kryeneçësinë
E barit të fishkur vjeshtor

SA QË I NDEZIN

Më kanë thënë se sytë e xixëllonjave
Ndriçojnë më shumë se yjet
E verbër
Dritën e huazojnë
Nga qeshjet e guaskave
Dhe kur flenë
I përngjajnë gjumit të mjellmave

Fluturimet e tyre madhështore
Asnjëherë nuk dështojnë
Aterojnë në çdo pistë ekzistuese
Dhe të nesërmen zgjohen
Në majat e majave të plepave

Nuk kanë nevojë
Për asnjë lloj karburanti
Çdo gjë që u nevojitet
Për fluturimet e interkontinentale
Huazojnë
Nga sytë e blertë të gjelbërimit

Kur është nevoja
I bashkohen gurit të stralltë të atdheut
Bëjnë aq shumë xixa
Sa që i ndezin flakadanët e lirisë

TË GJITHA TRAJTAT E DASHURISË

Kjo dhomë e fjetjes
Sa e madhe po aq edhe e vogël
Ku mund të zbulohen
Të gjitha trajtat e dashurisë

Ecim nëpër të me hapa somnambul
Shkelim nëpër shtigjet e gjumit
Në disa raste të rralla
Nuk i përngjajmë vetvetes

Nëpër çdo skutë fshihen sekretet
E pikave të shiut
Ku shpeshherë pikonte çatia
Duke i arnuar mendimet

I humbnim çorapët
Dhe në mëngjes tavolina shtrohej
Me pjatat dhe lugët e grindjes
Për hiç gjë
I shkundim të gjitha kujtimet

Kështu me grindjet tona të vogla
Dhe të mëdha
E ndërtuam kalanë e dashurisë që askurrë
Nuk pat njeri që mund ta merrte
As nga brenda e as nga jashtë

MBASE KA SHPIRT PAGAN

Në shtëpinë tonë në çdo kohë
Gjejmë tema të lira
Secili është besnik i papërmirësueshëm
I mendimit të vet

Flasim dhe kritikojmë njëri - tjetrin
Sipas meritës ja ofrojmë pjatën
Me fjalë kur ato nxehen
Mundohemi të mos e humbim busullën

Por askush nuk ma vë veshin
Secili prej nesh
Ka të drejtë në mendimin e vet

Njëri kundërshton ekzistimin e djajve
Kurse tjetri të engjëjve
Mbase ka shpirt pagan
Tërë kohën e kalon duke lexuar
Shtypin e verdhë

Fatmirësisht unë nuk i besoj askujt
Dhe asgjëje
Vesin tim kokëfortë
Të gjithë e tolerojnë

Dhe më japin të drejtë
Rri si një mumie
Në kanapenë time të zakonshme
Dhe merrem
Me problemet e mija fiziologjike

SANDALET E NATËS

Sonte nata është e pafundme
Njerëzit bredhin lakuriq
Si hijet e verdha
Bredhin të çmendurit
Nëpër zërin imcak të shiut

Askush nuk banon në këtë dhomë
Kot dëgjohen të trokiturat
Në një skutë të harruar
Mbyten nga të qeshurat
Sandalet e natës

Kush jeni ju që hyni kaq vonë
Në ëndrrën time
Mos ma ngacmoni sonte gjumin
Gati njëqind vjet nuk kam fjetur
Ju lutem ejani tjetërpasnesër

Sonte dua që kjo natë e pafundme
Të më përket vetëm mua
Njëqind vjet nuk më lënë të flejë
Ulërimat e ujkonjave të zeza

E TËRË LAGJA I MBYLLI DRITARET

Mendoj se sot është e mërkurë
Një ditë zakonshme e javës
Nuk doli në shitje shtypi i verdhë
Agjentët e kuq
E konfiskuan mbrëmjen

Një shi i imtë kishte humbur rrugën
Dhe gjithë kohën rigonte
Në përparësen e shqyer të ditës
Rigonte edhe mbi pemët
E dhunuara nga era

Njerëzit i kishte zënë një apati
Nga sytë e lëbyrtë pikonte anemia
E shiu i çmendur erdhi
Dhe dukej i bukur
Me këmishën e tij të bardhë

As të trokiturat e dyerve nuk u ndalën
E tërë lagja i mbylli dritaret
Neve nuk na mbetet asgjë tjetër
Përpos të presim
Se çfarë do të ndoll në mëngjes
Me liturgjinë e mbrëmshëm

Prishtinë, 28 janar 2014

BUZËQESH ARDHMËRIA

Në këtë qytet antik
Njerëzit jetojnë duke ecur
Kur i kapërcejnë malet e thinjura
Flenë si kuajt e egër

Asnjëherë nuk ëndërrojnë
Nuk kanë as pasione të sëmura
E nesërmja për këta njerëz
Është ajo pjesë e ditës
E cila domosdo duhet të vij

I urrejnë ëndërrimtarët
Në sytë e këtyre burrave
Si drita vezulluese
Buzëqesh ardhmëria

Nuk ka hekur që s'kalitet
Në duart e tyre
Edhe me shpirtin e stralltë të gurit
Bisedojnë në gjuhën shqipe

MIKU IM I VJETËR PREJ DRURI

Ecja ime është disi e shthurur
Po i merren këmbët e bastunit
Nëse ndalem të pushoj
Luhatem si plepi i vjetër

Ndodh që hapat e mi t'i përngjajnë
Hapave të devesë në shkretëtirë
Tundem udhëve si anijet mes dallgëve
Më mbanë për dore
Miku im i vjetër prej druri

Nëse ndjej lodhje
Ulem buzë Lumëbardhit
Pushoj te stoli i vjetër
Dhe tërë kohën e lume
Bisedoj me dallgët
Që fshehtas përbirohen mes guralecëve

Dikur vonë
Kur bie muzgu i mbrëmjes
Dhe kur fillojnë të dëgjohen serenatat
E kapi mikun tim për dore
Dhe çapitim si dy miq të vjetër
Deri te ëndrra e jonë
Që na pret me padurim në fund të rrugës

BURON NJË UJËVARË E BARDHË

Në rrapin e fshatit tonë
Si në një korr antik këndojnë zogjtë
Freskia rri mes gjetheve
Dhe e mbanë ison e muzikës së lashtë të erës

Nga kisha të cilës njerëzve
Nuk ju kujtohet emri
Vjen zëri i një kambane të padukshme
Por gjithsesi
Tingujt joshës na i ledhatojnë shqisat

Vijnë edhe disa zëra zogjsh
Vijnë nga largësia
E një kohe të shkuar
Dëgjohen edhe kalorësit e nëntokës
Dëgjohen
Duke i ngjeshur patërshanat

Nën rrapin e fshatit tonë
Si lumi
Buron një ujëvarë e bardhë
Dhe sikur në ndonjë legjendë
Gjarpëron
Mes përmes përrenjve të fshatit

SIÇ LUANTE ME ERËN

Më ka zënë ngushtë kjo skutë
Më ka zënë në befasi
Bishti i verdhë
I një zogu që s'di të fluturojë

Lakuriqësia e hënës
Edhe ajo më ka zënë ngushtë
Dhe më shikon me sy të verbër
Më shikon
Derisa më dridhen duart e frikës

Lartë mbi kokën time
lehje qensh
Nuk di
Nga po më vjen ky shqetësim
Në këtë natë të verbët

Skuta më zuri në befasi
Dhe luan me zërin tim
Luan si shiu
Siç luante me erën
Një lehje e trishtuar
Për herë të parë buron nga nëntoka

Mos vallë
Janë zgjuar kalorësit
Dhe kanë depërtuar
Me trokun e tyre të çmendur
Në mesin
E baladave të thinjura

Më ka zënë ngushtë
Skuta e fëmijërisë
Sa e madhe kjo dhomë e imagjinuar
Për shpirtin tim të vogël

Mbi plisin e tokës
Cikli i tretë

PO KU DI POETI

Miku im përherë më pyeste
Nga diçka
Që paraprakisht ishte i sigurt
Se s'kam përgjigje për astrologjinë

Po ku di poeti
Për transaksionet bankare
Ose se si zbresin nëpër pistat e botës
Avionët prej letre

Pyetjet e tija
Dukeshin si një lumë i çmendur
I cili me sy të mbyllur
I kalonte kataraktet si anijet e thyera

Pyeste për hapin e devesë
Në shkretëtirë e mbytur prej etjes
Së breshkave të rërës së paanë
Kur kaktusi vuante nga sëmundja e lisë

E shumë e shumë pyetje të çmendura
Për gjenet e mushkonjës
Kurse poetët dinë
Vetëm marrëzisht të dashurohen
Në pikëpyetjen
E gjenezës së fjalëve abstrakte

Çuditërisht një ditë më pyeti
Për prejardhjen e hënës
Sa budalla ishte miku i astronom
Kur mua më pyeste
Për itineraret e meteorëve
Dhe të kometave
Që përherë kanë qenë
Klandestinët e gjithësisë

SOT PO BIE NJË SHI I DYSHIMTË

Ne përherë jemi duke ecur
Nëpër një gjysmë drite të mjegullt
Nuk dimë se ku na qon
Kjo rrugë qorre
Nata është e errët
I përngjan syve të gënjeshtrës

Por ne kurrsesi nuk ndalemi
Depërtojmë nëpër shpirtrat lakuriqe
Të pemëve
I përshëndesim turtujt e verbër
Dhe kur bien në tokë gjethet e fundit
Trokasim në dyert e degëve

Dhe pastaj sërish ecim
Përtej asaj kodre
Është një rrugë tejet e gjatë
Përtej asaj rruge pa dalje
Sërish një tjetër udhë
E cila asnjëherë nuk përfundon
Në zërin e gërnetës

Sot po bie një shi i dyshimtë
Po bie si perëndit
Mbi flokët e ngjyrosura të pritjes
Kurse njerëzit
Akoma nuk i kanë ndalur ecjet
Ecin e ecin
Deri të flokët e thinjura të mjegullave

NDOSHTA FRIKOHET

Pa i hapur sytë
Ajo për çdo mëngjes
Mi prek flokët e gështenjta
Ndoshta frikohet
Mos janë thinjur gjatë natës

I prek edhe duart e mia
Më kallo
Pohon se pa masë i pëlqen vrazhdësia
E lëkurës sime zeshkane

Posa i hapi sytë shoh
Se si më ka hipur mbi shpatulla
Një pjesë e bardhë e ditës
Kurse ajo tjetra
Vrapon si suta e egër maleve

Pas shpine
I gjuaj çarçafët e djersitura
Ashpër proteston
Pjesa e brendshme e jorganit

Gota gjysmë e zbrazur
E verës së kuqe
Më shikon me qesëndi
Të pashpjegueshme

Kolliten muret e jashtme
Të shtëpisë
Në stelën te mani egër
Nuk ndalet as kuisja e qenit

Stufa hingëllon
Hingëllon si kali i ujit
Mbi çatinë e zbardhur të viteve
Pjalmon një borë e re

Prishtinë, 29 janar 2014

MBI PLISIN E TOKËS

Sonte nuk kam gjumë
Vetëm gjëma e Drinit të bardhë
Ulërin
Në vetëdijen time të përgjumur

Po kallen lisat
Mbi plisin e bardhë të tokës
Po vërshojnë përrenjtë e çmendur
Të shekullit
Po vërshojnë parathëniet e fantazmagorive

Kjo stinë e gjatë e dimrit
Në shpirtin tim
Po i mbjellë kallkanët prej kristali
Çfarë të bëjë me lotin e ngrirë
Mështekna e verdhë dhe bufi
Mbrëmë dënesën një kohë gjatë

Nuk pushonte as pjalmimi i acartë
Një ortek i akullt po i mbulon çatitë
Ky dimër
Ndoshta do na sjellë ndryshime
Ndoshta pranvera
Do kthehet e buzëqeshur
Sepse përherë në mars
Çelin sytha gjethet e reja

NJË MJELLMË E PLAGOSUR

Në Kosovë po bënë shumë ftohtë
Patat e egra
S'fluturojnë më këndej pari
Mbase janë strukur
E po ngrohen
Diku mes mjegullave dhe diellit

Edhe mua më zuri kurthi i acartë
Sonte dukem tepër i mërdhirë
Nga loti i erës
Për herë të parë pikon
Një lëng i tejdukshëm
Dhe i përngjan syrit të ngrirë

Në shtrojerë po qajnë akaciet
Një mjellmë e plagosur
Ka mbetur e vetmuar në mol
Llambat e fanarit
Nuk bëjnë më dritë
Ku do t'i varrosim rosat e egra

SHI NË QYTETIN TIM

Nata i paska mbyllur të gjitha dritaret
Askush nuk hynë
As nuk del nga dhembja ime
Një gjel i kërthndezur
Zgjon mëngjesin e përgjumur

Te Ura e Gurit
Fle gjarpri i shtëpisë
Fle edhe ëndrra e Lumëbardhit
Një zog shtegtarë
Mbi çatinë e verdhë të ujit
Me mallëngjim këndon një serenatë

Rigon edhe nga pak shi
Në lotin e erës
Rigon mbi nostalgjinë e fëmijërisë
Nga Kalaja e Vashës
Fluturojnë dy zogj të shenjtë

Një përrua e vogël si nëpër një ëndërr
I vërshoi kalldrëmet
Shiu akoma nuk pushoi
Në lotin e erës
Po bie pa reshtur
Po bie shi në qytetin tim

KTHEHUNI NË ATDHE

Kthehuni para se t'i harroni rrugët
Ky pjalm i verdhë bore
Duket vetëm njëherë në vjet
Kur hëna zhytet
Në gjumin e mëngjesit

Ju kthehuni të dashurit e mi
Sa nuk është bërë vonë
Nëse kalon vjeshta
Nuk mund t'i kapërceni
Rrugët e dimrit
Malet tona janë të ashpra
Në këtë stinë të verdhë

Nuk di se sa pranvera i keni me pritur
Për kthimin e juaj
kthehuni sa është koha e mirë
Nëse vonoheni
Edhe shumë dimra të tjerë keni me pritur

Ju përgjëroj kthehuni
Po që se i harroni rrugët
Ju dhe shpirti i juaj
Do të shndërrohet në harresë
Kthehuni të dashurit e mi
Kthehuni në atdhe

NJË KAMBANË E LËNGTË

Mbi njëqind vjet
Lumëbardhi po rrjedhë i verdhë
Algat dhe myshqet
Nën shpirtin e guralecëve të bardhë
Shkruajnë epitafin e rrjedhës

Ky lumë që po kalon
Çmendurisht po rrjedhë
Nëpër gjumin e murrmë të qytetit
Kush e zgjoi Xhuma Xhaminë
Kur qyteti i dorëzonte çelësat e kalasë

Një kambanë e lëngtë
E cila po vajton me qindra vjet
Akoma nuk po ecën në këmbët e veta
I ka hipur mjegullave
Dhe nuk ka të ndalur sonte
Qyteti kurrë më parë
Nuk i kishte humbur udhët si sot

MALET I HAPËN SYTË

Kur jemi të tendosur
Ecim trotuareve duke u fshehur
Pas një mjegulle të zezë
Aeroplanët e verbër aterojnë nëpër pista
Të përgjumura të ëndrrave

Ikja e çafkave ishte një ogur i mirë
Për herë të parë
Malet i hapën sytë
Dhe filluan të zbresin në qytet
Të zbresin
Me tërë oshtimën e zërit
Dhe zbritën ëndrrat e djemurisë

Mes kolonadave të mermerta
Zbritnin edhe engjëjt
Kolona e gjetheve në mars
Dukej si bisht kuçedre
Pas njëmijë vjetëve nënshtrimi
U ndezën flakadanët
Për të mos u shuar asnjëherë

Prishtinë, 30 janar 2014

E CILA TË PRET NË BEFASI

Po deshe ta gjesh zjarrin e shenjtë
Me duart e tua prej kallos
Mbylli sytë
Dhe fundosu si në ndonjë ëndërr
Në lumin e errësirës

Ose ulu përreth tangarit
Me pasardhësit e tu
Dhe bisedo për të nesërmen
E cila të pret në befasi

Ulu dhe ndizi flakadanët e mendjes
Gjeje atë zjarr të ndezur
Në shpirtin tënd
Të cilin vetëm poetët e kanë

Dhe sa herë që donë
E gjejnë në mesin e parathënieve
Për t'i ndezur
Zjarret e pa ndezura të Olimpit

2.

Ajo frymëmarrje që nuk shuhet
Në shpirtin e drurit
Është vetë njeriu që ecën
Nëpër brishtësinë e sipërfaqes së asteroidit
Për ta zgjuar
Ëndrrën e kahershme të deltës

Është vet zjarri i mendjes
Së shenjtë
Që shpërthen nga nëntoka
Dhe përherë rri i ndezur
Për të mos u shuar asnjëherë
Në shpirtrat e perëndive pagan

POR KUR HIDHËROHEN

Janë njerëz mistik
Bashkëjetojnë me fjalët misterioze
Lindin dhe vdesin me misticizmin
Deri në asgjësim
Ecin nëpër tehun e mprehtë të shpatës

Durimi i tyre është aq i madh
Sa që nga rrënja e tokës shtrydhin
Lotin e gjelbër të barit
Por ka diçka madhështore
Në shpirtin e tyre
Më shumë se Hyjin e duan atdheun

Me një ngjyrë jeshile
I mbështjellin të gjitha ëndrrat
E mbajnë veten për zot të yjeve
Si vashën e bukur e puthin verën
Por kur hidhërohen
I thyejnë të gjitha gotat e kristalta

SECILI PREJ NESH

Secili prej nesh
Nga disa herë në ditë
Bëjmë vetëvrasje
I mbushim xhepat e sëmundjes
Me nga disa lloje
Pakosh të mykura të cigareve
I mbushim
Dhe fshihemi pas vetvetes

Në të vërtet
As vetë nuk dimë
Se si do të dukemi nesër
Duke ecur rrugëve
Me shpirt të karbonizuar
Bartim barrën e ditës së tymosur
I përngjajmë
Gurit të murrmë të Sizifit

Asnjëherë nuk ditëm të mendojmë
Si do të dukemi tjetërpasnesër
Dhe kujt do t'i përngjajmë
Çfarë do të na tregoj ashti
I dorës së djathtë
E çfarë ajo e majta
Që kundërmon thëngjill të kalbur

MOS ARDHTË MË KURRË

Mbrëmë ishte një natë e ankthshme
Makthi i kishte hapur sytë
Dhe më shikonte
Më shikonte
Si dhelpra kokrrat e rrushit
Në pjergullën e trishtimit

Ishte një natë të cilën s'do të doja
Kurrë më ta përjetoja
Nata e një trishtimi të përzier
Pakëz me ëndrrën
E pakëz më shumë me zhgjëndrrën
Mbi qafën time të regjur
Rëndonte një shpatë e topitur

As nuk më shqyente ajo bishë e metaltë
As nuk më linte të fle
Edhe gjumi i thinjur nga tmerri
Mu bë haram
Mos ardhtë më kurrë
Një natë si kjo
Mos përjetofsha asnjëherë
Një zhgjëndërr të tillë

KALORËSIT E GURTË

Pak kush mund të kuptoj
Gjuhën e rrugëve
Ato gjithmonë lindin
Dhe vdesin vertikalisht

Si urithi depërtojnë nëpër shpirtin e tokës
Kur arrin në pjesën e zjarrtë
Pjekin gështenja
Ose vetë piqen deri në asgjësim

Përherë janë pa këpucë
Por galopojnë
Nëpër shpirtin e erës
Si kalorësit më të mirë të nëntokës

Dhe sa herë thërrasin vetëtimat
I zgjojnë nga gjumi
Kalorësit e gurtë
Duke i ledhatuar krifat e atdheut

Prishtinë,31 janar 2014

U BESOJNË DJAJVE

Njerëz të bezdisshëm ecin duke përsëritur
Psalmet dhe lutjet misterioze
Të një kohe pagane
Nga flokët e tyre pikojnë
Trishtimet e mjegullave

Nuk njohin asnjë Zot
Nga mosnjohja dhe frika
U besojnë djajve
Jetën e lidhin për një fije floku të thinjur
Dhe haleluja e tyre kalon në bezdi

Udhëtojnë me trena të çmendur
U përngjajnë patave të egra
Nëpër kupetë e vagonëve
Fundosen në ëndrrat e dritareve
Dhe e zgjojnë mëngjesin
Nga gjumi i tij letargjik

Nuk ndalen në asnjë stacion
Të boshatisur
Po që se ndalen atëherë shoqërohen
Me macet dhe qentë endacak
Shoqërohen
Derisa ngjizen me mjaullimat e natës

E KAFSHOI ACARI NË SHPIRT

Për gozhdën e ndryshkur të moteve
Ri një kornizë e varur
Diçka misterioze fshihet
Pas portretit të erës së shqyer

Bisqe gjëmash mbinë
Mbi thinjat e viteve
Pjalmon stuhia në retrospektivë
Pjalmojnë ditët e shkuara

Thonë se ditën kur u linda
Kishte rënë një borë e madhe
Zërin tim të grithur
E kafshoi acari në shpirt

Dhe kurrë
Më nuk u shëruan plagët e dhembjes
Akoma sot
I ndjej këlthitjet e asaj dite

Kishte rënë edhe një shi i ngrirë
Atë ditë
Ishin dëgjuar britmat e çative
Nga acari ngufateshin oxhaqet

Nëpër të çarat e drurit të moçëm
Një copë mishi merrte frymë
Dhe qante me dënesje
Për të mos pushuar asnjëherë më

Prishtinë, 01 shkurt 2014

SHËNIME BIOGRAFIKE PËR AUTORIN

Adem Zaplluzha u lind në Prizren, më 1943. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në *Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990*, nga Hasan Hasani, në *Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995* nga Odhise K. Grillo, si dhe në

librin *Portrete Shkrimtarësh* nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë ndërsa aktivitetin letrar e zhvillon në kuadrin e Klubit letrar "Fahri Fazliu", në Kastriot

BOTIME TË AUTORIT

1. **“Puthje”, poezi,** “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “**Ecjet e viteve të mëdha”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. **“Çamarrokët e Thepores”,** poezi për fëmijë, “Shkëndija”,Prishtinë 1996.
4. **“Muret”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.
5. **“Morfologjia e dhembjes”,** poezi, “Faik Konica”, Prishtinë,2000
6. **“Ai vjen nesër”,** poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar“Fahri Fazliu”, Kastriot, 2oo7
7. **“Letër nga mërgimi”,** poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu”Kastriot , 2007
8. **“Letër nga mërgimi 2 “** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. **“Udhëndarja”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o. **“Thirrje e gjakut”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. **“Asgjë sikur molla”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. **“Vesa në lotin tim”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “**Puthja e gozhduar”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2oo9.
14. **“Kashelasha në vargje”,** poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2oo9.

15. **“Pema e bekuar”,** E përkthyer, Rumani, 2o1o.
16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. **“Hijet e ndryshkura”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
18**.”Stuhi në Kutulishte”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
19. **“Posa ikte nata”,** poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
2o**. “Loja e myshqeve”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. **”Lumëbardhi dhe gjëma”,** poezi,”Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
22**. “Metafora e heshtjes”,** poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
23. **”Hyji në Prekaz”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. **”Sinorët e hinores”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. **”Don Kishoti dhe Rosinanti”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26**.”Zjarri i dashurisë”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. **”Kur likenet vallëzojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28**. “Ditari në vargje”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 201O
29. **“Tingujt që nuk përfundojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o1o.
3o**. “Shtegu i mallit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010

31. **”Korniza e thyer”’**,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010
32. **“Zgjimi i gjëmës”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. **“Vallja mistike”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2010
34. **”Merre kodin”,** Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot,2011
35. **“ Letër atdheut”** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. **“ Tejdukshmëria e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
37. **“ Përtej teje”**,poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. **“Sa afër e sa larg”** , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2011
39. **“Vallja e zanoreve”,** Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
40. **“Ikja e eshtrave”,** Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
41**.”Kalorësit e mjegullave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. **“Hingëllimat e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. **“Kur pemët i ndërrojnë këmishët”.** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
44. **“Mirëmëngjes Imzot”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
45**. “Kafshimi i mikut”,** Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. **“Atje tej maleve”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012

47. **“Heshtja që del në shesh,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2o12
48. **“Portat e shpresës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. **“Në dhomën time gjysmë të errët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
5o. **“Kinse Lojë Shahu”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
51. **“ Për çdo dekadë nga një baladë “,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
52. **“Fusha e mëllenjave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
53. **“E kujt është kjo vetmi”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
54. **“Mos pyet për adresën e lumit”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55**. “ Stoli në parkun vjetër”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. “**Urori i stralltë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
57**. “Po të mos ishte fjala”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2o12
58. **“Thyerja e urave”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
59**. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
60**. “ Në flokët e dëborës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61**. “Një grusht nostalgji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
62. **“ Kur filluan të flasin njerëzit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012

63. **“Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot,2012
64. **“ Lisi në rrënjët e veta”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2o12
65. **“Eca ecëm dhe do ecim”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
66**. “Fëmijët e erës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. **“ Çast në fund të stinës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. **“Si të flas me drurët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69**, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70**. ”Andej dhe këndej kohës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71**. “Zëri i heshtjes”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
72**. “Kush i lexoi letrat prej erës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73**. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”,** prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. **“Koha e ime dhe koha e jote”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75**.” Diku te një baladë”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76**. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”**,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
77 **“ Ky def prej hëne”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012

78**.“Pyesni zogjtë në ikje ”,**Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013
79 **“ Fërfërimë gjethesh**”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
80**. “Refrene yjesh”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
81. **“Te delta e mjellmave”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
82.**“Rinjohja”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
83**.“Diku në fund të një fillimi”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
84**.“Makthi i hijes”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”Kastriot, 2013
85.**“Një zog prej uji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot
86**.”Asnjë fjalë nuk frymon”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014-
87**.”Daullet e një nate”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot 2014
88**.”Sytë e gurtë të erës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
89**.”Kur dehen perënditë”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014
90. **“Fjetëm njëqind shekuj”**Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot , 2014
91**.”Krakëllimat e natës”,**Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
92. **“Ndjekësit e enigmave”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014

93. **“Atdheu i paçmuar**”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
94**.”Psalm i harruar ”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
95,”**Për më po bie moj kambanë**”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
96. **“Mbi flokët e ullukëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. **“Menatë vijnë lejlekë**”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98**. “Loti i gotës së dehur”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99**. ” Stina asnjanëse”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. **“Dëneste bashkë me erën”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. **“Druri i pikëlluar**”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
102. **“ Një grusht dashuri”** , poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
103. **“Lëreni zërin tim”** , poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
104. **“Shi në qytetin tim” ”** , poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014

PËRMBAJTJA

Kah po ikin ditët - Cikli i parë 7
Asnjë mur nuk hapet 9
2. 10
3. 11
4. 12
5. 13
Piktori i jep shpirt gurit 14
Kah po ikin ditët 15
Mbrëmë qante era 16
Nata ishte e gjatë 17
Kam frikë 18
Një pikë loti këtu 19
Nuk është më ajo grua 20
Janë lodhur edhe degët 21
Kur qan druri 22
Njerëzit e qytetit tim 24
Sa herë që u teket 26
Thua se vajtonte edhe hyji 28
I shembi të gjitha muret 30
Një sy i hapur deti 31
E rastisi lustraxhiun Bajram 33
Nëpër stacionet e pritjeve - Cikli i dytë 35
Kurse ne vendnumërojmë 37
Sytë i kemi të uritur 38
Po thahen pemët e pjekura 39
Dy të dashuruar 40
Dua që në këtë vetmi 41
Në disa raste ekstreme 43
Pa pasaportë biometrike 44

Mos është çmendur bunaca 45
Kur prishet moti 46
Më presin të parët e mi 47
Atdheu është shumë larg 48
Nëpër stacionet e pritjeve 49
Dimri kurrë nuk zë vend 51
Po që se zemërimi 52
Fillon stina e kallkanëve 53
Si duart e xehetarëve 54
Sa që i ndezin 55
Të gjitha trajtat e dashurisë 56
Mbase ka shpirt pagan 57
Sandalet e natës 59
E tërë lagja i mbylli dritaret 60
Buzëqeshi ardhmëria 61
Miku im i vjetër prej druri 62
Buron një ujëvarë e bardhë 63
Siç luante me erën 64
Mbi plisin e tokës - Cikli i tretë 67
Po ku di poeti 69
Sot po bie një shi i dyshimtë 71
ndoshta frikohet 73
Mbi plisin e tokës 75
Një mjellmë e plagosur 76
Shi në qytetin tim 77
Kthehuni në atdhe 78
Një kambanë e lëngtë 79
Malet i hapën sytë 80
E cila të pret në befasi 81
2. 82
Por kur hidhërohen 83
Secili prej nesh 84

Mos ardhtë më kurrë 85
Kalorësit e gurtë 86
U besojnë djajve 87
E kafshoi acari në shpirt 88

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Shi në qytetin tim / Adem Zaplluzha. - Kastriot : Shtëpia Botuese “ Fahri Fazliu”, 2014. - 102 f. ; 21 cm.

Shënime biografike për autorin : f. 92-99

ISBN 978-9951-664-20-2